

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRËS

Nr.Regj.Them.436/1

Data e regjistrimit 14.7.2015

Nr.Vendimit 436/1

Data e vendimit 27.7.2015

VENDIM
“PËR CAKTIM SEKUESTRO PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e përbërë prej:

GJYQTAR TRITAN HAMITAJ

Asistuar nga sekretare seance **Edlira Mehmeti**, sot më datë 27.7.2015, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen penale-administrative Nr.436/1 Regj.Them, që i përket palëve:

Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrëse e përfaqësuar nga prokurori Afrim Shehu.

Kundër: dhe

Objekti: Vendosje e masës së sekuestros preventive.

Baza ligjore: Nenet 274 të K.Pr.Penale.

Gjykata dëgjoi palët që kërkuan:

Prokurori: Kërkojmë vendosjen e sekuestros preventive, mbi pasurinë me Nr.2/980, vol.46, fq.98, zona kadastrale Nr.8511, me sipërfaqe truall 178 m 2 dhe sipërfaqe ndërtimi 76 m 2 në emër të , e ndodhur në Durrës. Pasuria Nr.27/168 N D-N2, vol.55, fq.195, sipërfaqe 119.2 m 2, të ndodhur në Lagjen nr. Plazh Durrës, në emër të .

Gjykata pasi analizoi provat dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr 237/2010 në ngarkim të dyshuar se ka kryer veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtari kriminale” parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Në datën 6.7.2015 Prokuroria ka paraqitur kërkesën për vendosje sekuestro preventive për pasuri të paluajtshme në pronësi të duke pretenduar se:

shtetasi , i datelindjes , është raportuar për transaksion financiar me date 14.10.2008 të kryer nga llogaria e tij bankare në bankën nje shumë prej 84 000 USD. Po ky shtetas me date 04.05.2009, ka kryer nje derdhje cash, prej 56 000 GBP(Paund). Me shkresën Nr. 611/1 KL/Prot BM 452, date 26.03.2012, Interpol Tirana ka informuar se shtetasi vëltrimi i datelindjes 23.01.1981, është dënuar në Britaninë e Madhe për veprën penale

"Mashtrimi" per të cilën është dënuar me 6 vjet burg dhe me pas është vendosur largimi i detyruar këtij shtetasi nga territori Britanik.

Shtetasi () i datelindjes 23.01.1981, ka perdorur në shtetin Anglez, emrin e vëllait të tij , i cili ka ndërruar emrin në , pas vitit 2002.

Shtetësi ka investuar ne pasuri të Paluajtshme dhe të paluajtshme, si me poshte:

- Me date 30/4/2004 ka blere dyqan me sip ndërtimore 96 m/2 me cmim 8.000. 000 lekë.
- Me date 30/4/2004 ka blere shesh me sip ndërtimore 252 m/2 me cmim 1.100.000 leke.
- Me date 11.06.2006, ka blere automjet tip Benx me targë DR 369 Ane vlerën 4.500 Euro.
- Me date 10.09.2006, ka blere automjet Tip Benx me targë DR 9573 D, në vlerën 250.000 lekë.
- Me date 28/10/2008 ka blere njesi me sip ndërtimore, 119.2 m/2 me omim 11.997.480 lekë.
- Me date 08/02/2009 ka blere apartament me sip ndertimore 65 m/2 me cmim 1.900.000 lekë.
- Me date 06/09/2009 ka blere garazh me sip ndërtimore 21.26 m/2 me cmim 1.900.000 lekë.
- Me date 09/06/2009 ka blere apartament me sip ndërtimore 106 m/2 me cmim 1.900.000 lekë.

Ne total vlere e investimeve në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme (shpenzime) që jane kryer nga shtetasi jane të barabarta me 27.047.480 lekë dhe 4.500 EURO.

Ndërkohë që ky shtetas ka realizuar, Si te ardhura nepermjet shitjes dhetë ardhura të tjera si me poshte:

- Me date 24/12/2004 ka shitur nje objekt me sip. Ndertimi 96 m/2 me cmim 1.500.000 lekë.
- Me date 24/12/2004 ka shitur nje objekt me siperfaqe 90m/2 me cmim 450.000 lekë.
- Nga aktiviteti tregtar restorant gjate viti 2004 ka realizuar si të ardhura të tatueshme 1.537.500 lekë.
- Per vitin 2007, 2008 dhe 2009 te ardhura të realizuara nga transporti me taksi 8.000.000 lekë.

Ne total vlere e të ardhurave të realizuar nga shtetasi jane te barabarta me 11 487 500 lekë.

Midis të ardhurave të deklaruar nga burime te ligjshme dhe shpenzimeve të investuara në pasuri te luajtshme dhe të paluajtshme, ka një diferencë negative në vlerën 15.559.980 lekë dhe 4.500 EURO.

Me shkresën me Nr. MLIE020I2ALBA15 167, date 18.05.2012, janë administruar nga Autoritetet Gjyqesore Kompetente të Mbretërisë së Bashkuar, per shtetasin , i datelindjes 23/01/198 1, keto te dhëna:

Ne muajin prill te vitit 2009 është akuzuar, per bashkepunim ne aktivitetin kriminal per "Prodhimin dhe furnizimin e dokumenteve te udhetimit dhe identifikimit, te falsifikuara". Aktiviteti kriminal ka filluar nga vera e vitit 2007 derisa ne prill 2009 u be arrestimi i bashkepunetoreve kryesore. Ka perdorur emrin e rreme dhe . Ka të dhena se dokumentet e falsifikuar kane filluar te prodhohen te pakten nga Qershori i vitit 2008. Eshte arrestuar me date 17 prill të vitit 2009. është shpallur fajtor nga gjykata dhe eshte denuar per "Bashkepunim kriminal per falsifikim" me date 16/09/2009, me 6 vjet burgim.

Te ardhurat e tij në shtetin Anglez, ng apuna jane:

- Per 2007/2008 te ardhurat jane në shumen 5.010 paund.
- Per 2007/2008 te ardhurat jane ne shumen 7.800 paund
- Ne emër te rreme jane te deklaruar pane zyres se ardhurave dhe Doganave perfitime neto ne shumen 12.310 paund.
- Ne baze te dhënave bankare ka bilanc deri, me date 15/02/2011 - 15.090 paund; -
- Ne baze te dhënave bankare ka bilanc deri me date 15/02/2011 - 2.100 paund

Ne baze te dhënave bankare ka bilanc deri me date 15/02/2011 1.400 paund

Sipas të dhënave te administruara me leterporosi, rezulton se nga sjellja kriminale e shtetasit janë siguruar të ardhura në vlerën 888.690 paund.

Formularët e taksave dhe të pandehurit ne emrat dhe tregojne se te ardhurat e tij te deklaruar per periudhen perkatese shkojne deri ne 17.714 paund, duke i pershkruar si me poshte:

- a. Depozitat totale (Ilogaria e perbashket nuk është perfshire) 269.686 paund.
- b. Të ardhurat bruto të deklaruar per të ardhurat e brendeshme 17.714 paund
- c. Diferenca mes depozitave dhe te ardhurave të ligjshme është 251.972 PAUND,

Cdo pasuri e gjetur ne cdo kohe pas dates se denimit u sigurua si rezultat i sjelljes se tij te zakonshme kriminale. Cdo shpenzim qe eshte bere pas dates perkatese ka qene si rezultat i sjelljes se tij të zakonshme kriminale. Cdo pasuri e siguruar skishte te bente me interesate tjera. Persa kohe qe burimi i parave te sipërpermendura nuk është identifikuar, del se parate kane ardhur nga sjellja kriminale e te pandehurit.

Nuk ka te dhëna per burimin nga kane buruar të ardhurat por duke u nisur nga të dhënat e leterporosisë, rezulton se si rezultat i sjelljes së zakonshme kriminale ne shtetin Anglez, shtetasi ka depozituar shumën 441.027 euro, të cilat dyshohet se jane të ardhura nga aktiviteti kriminal i falsifikimit të dokumenteve të identifikimit dhe te transportit. Këto shuma jane terhequr nga ky i dyshuar dhe jane derguar në Shqiperi, dhe me pas jane investuar nga shtetesi i cili në total ka lëvizje bankare, nga data 01.01.2003 deri ne date 17.12.2010, -276997 USD dhe 254 116 USD, në monedhën GBP -500917 Paund dhe në 500 871 EURO.

Shtetasi, ne lidhje me burimin e te ardhurave ne Angli, ka deklaruar se ato kane ardhur nga aktiviteti i restorantit në Shqiperi. Ky aktivitet ne Shqiperi eshte hapur nga në vitin 2004 dhe eshte mbyllur ne mesin e muajit Janar, te vitit 2005 dhe të ardhurat e deklaruar nga ky aktivitet per të cilët jane paguar tatimet është i barabartë me 1 537 500 leke.

Ne emer te shtetasit, jane te regjistruara në regjistrat publik pasurite e poshte shenuara:

- Pasuria me nr. 2/228, vol 18, fq.75, e ndodhur në adresa iagja nr: 18 rruga A. Goga, ku eshte e regjistruar nje apartament, me siperfaqe 65 m/2, nr dokumentit 5349, date 08.05.2009, me vlere 3.211.663 leke.

- Pasuria me nr. 26/72 - G2, vol 14, fq. 222, e ndodhur në adresë në lagjen nr. 13 plazh, garazh, me siperfaqe e pasurisë 21.26 m/2, nr dokumentit 6682, date 06.09.2005, vlere 1.900.000 leke.

- Pasuria me nr.26/72 + 110, vol 14, fq. 231, me adrese në lagjen nr. 13 plazh, apartament, siperfaqe e pasurise 106.0 m/2, nr. dokumentit 03682, date 09.06.2009, vlere 1.900.000 leke.

- Pasuria me nr, 27/168 NB - 47, vol 55 fq 195, ne adresen lage nr. 13, plazh Durres, siperfaqe e pasurise 119.2 m/2, ref 010387, nr. dokumenti 10989, date 28.10.2008, me vlere të pasurise 11.997.480 leke.

Përsa me sipër ka fakte dhe prova te mjaftueshme se shtetasi () ka kryer veprën penale "Pastrimi I produkteve te veprës penale" parashikuar nga neni 287. 1, germa" a & b" te Kodit Penal.

Nga analiza e të dhënave te me sipërme arrijmë në këto konkluzione:

Shtetesi është person me precedente penale i dënuar nga autoritetet gjyqesore ne Londër, Angli me datë 17.12.2009, per bashkepunim kriminal per mashtrim në 17.04.2009, me 6 vjet burgim, duke rekomanduar dhe denim plotesues me dëbim dhe konfiskim të artikujve, sipas nenit 223, qe ka blerë në këtë shteti përpara se të deklarohet fajtor.

Ndryshimet e gjeneraliteteve të tij dhe vëllait) janë tipike për persona që kanë qenë të dënuar jashtë shtetit dhe të ardhurat apo pasuritë e perftuara nga këto aktivitete realizojnë në Shqipëri, duke i fshehur apo paraqitur si aktivitete tregtare të ligjshme.

Mungesa e një aktiviteti të ligjshëm tregtar, për të justifikuar të ardhurat e blerjes dhe ndërtimit pasurive të paluajtshme.

Ekzistenca e disa pasunive të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat janë të vendosura në periudhë kur shtetasi ka kryer aktivitetin kriminal në shtetin Anglez dhe më pas.

Kryerja e transaksioneve bankare në vlera të konsiderueshme dhe të pa justifikuara nga pikepamje ekonomike me burimet e ligjshme të të ardhurave të tyre dhe kryesisht nga banka që vijnë në Angli.

Regjistrimi i pasurive në emër të shtetasit si dhe transaksionet fiktive në emër personave të tjerë, dhe kryerja e transaksioneve në emër të tij janë veprime të kryera për të fshehur origjinën e paligjshme të pasurisë së krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë kriminale në shtetin Anglez tregojnë qartë qëllimin e fshehtë ose mbulimit të natyrës së vërtetë të burimit të të ardhurave dhe ditur që janë produkt i veprës penale, duke kryer veprën penale "Pastrimi produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

Prokurori ka kërkuar sekuestron preventive për pasuritë e paluajtshme dhe gjykata me vendimin nr. 436 datë 8.7.2015 e ka pranuar sekuestron preventive mbi pasuritë:

- Pasuria me nr. 2/228, vol 18, fq.75, e ndodhur në adresë lagja nr. 18 rruga A. Goga, ku është regjistruar një apartament, me sipërfaqe 65 m/2, nr dokumentit 5349, date 08.05.2009, me vlerë 3.211.663 lekë.

- Pasuria me nr. 26/72 - G2, vol 14, fq. 222 , e ndodhur në adresë në lagjen nr. 13 plazh, garazh, me sipërfaqe e pasurisë 21.26 m/2, nr dokumentit 6682, date 06.09.2009, me vlerë 1.900.000 lekë.

- Pasuria me nr. 10/10, vol 14, fq. 2 me adresë në lagjen nr. 13 plazh, apartament me sipërfaqe e pasurisë 106.0 m/2, nr, dokumentit 03682, date 09.06.2009, vlerë 1.900.000 lekë.

- Pasuria me nr, 27/168 ND - 47, vol 55, fq 195, në adresën llogje nr. 13, plazh Durrës, sipërfaqe pasurisë 119.2 m/2, ref 010387, nr. dokumenti 10989, date 28.10.2008, me vlerë të pasurisë 11.997.480 lekë, në emër të shtetasit

Gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit është konstatuar se pasuria me nr, 2/22/ + 1-1, volum 9, faqe 121, zona kadastrale 8511, për sipërfaqe apartament nuk është në emër të shtetasit por është në emër të shtetasit

Kjo pasuri është e mbyllur nga ky shtetas dhe është regjistruar nga ana e tij pasuria me nr. 2/980, zona kadastrale 8511, nga volum 46, faqe 98 në volum 46 faqe 100, në adresën rruga A.Goga me sipërfaqe truall 178 m/2 dhe sipërfaqe ndërtimi 76 m/2. Kjo ndërtesë është vile, për të cilën është leshuar çertifikata e regjistrimit me date 27.04.2015. Ky objekt është regjistruar sipas shkresës me nr. 4771, date 02.04.2015 të Agjencisë Legalizimit të Durrës.

Nga dokumentacioni i dosjes së legalizimit rezulton se pagesat për këtë objekt janë kryer nga shtetasi. Në bazë të prokurës së përgjithshme me nr. Rep 466, nr. Kol 87/3, date 26.02.2015 rezulton se shtetasi

emërojnë si përfaqësues ligjor të posaçem shtetasit për ta përfaqësuar në lidhje me këtë pasuri pranë organeve shtetërore dhe çdo të drejtë tjetër. Në këtë mënyrë ky objekt rezulton se është në posedim të shtetasit

Ne lidhje me ekzekutimin e vendimit të gjykates per vendosjen e sekuestros konservative ne lidhje me pasurine me nr. 27/168 NB - 47, Vol 55, fq 195 ne adresen lagja nr. 13 plazh durrës, nuk është në emër të shtetasit [redacted] por është blerë nga shtetasi [redacted] i cili e ka shitur dhe aktualisht kjo pasuri është në emër të shtetasve [redacted], sipas kontratës së shitjes me nr. Rep 117, nr. Kol 104/1, date 11.03.2013 dhe është rregjistruar në hipoteke në emër të shtetasve [redacted] dhe [redacted] me date lëshimi çertifikate 04.10.2014.

Duke qene se te dy pasuritë janë në posedim të shtetasit [redacted] por fiktivisht janë vendosur në emër të shtetasve të tjere për te dy pasuritë duhet të vendoset sekuestro preventitive për shkak se administrohen nga shtetasi [redacted], i cili e ka kryer këtë veprim për t'ju shmangur pasojave në lidhje me keto pasuri që te mos jene në emrin te tij ne regjistrat publik.

Sa me sipër, dyshohet pasuritë në emër të shtetasit [redacted] te jenë produkte të veprës penale, bazuar në nenin 274/2 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurori kërkoi plotesimin e vendimit duke urdheruar vendosjen e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive dhe mbi pasuritë:

Pasuria me nr. 2/980, zona kadastrale 8511, nga volum 46, faqe 98 ne volum 46 faqe 100, ne adresen rruga A.Goga me sipërfaqe truall 178 m/2 dhe sipërfaqe ndertimi 76 m, ne emër te shtetasit [redacted]

Pasuria me nr, 27/168 NB - 47, vol 55, fq 195, ne adresen lage nr. 13, plazh Durrës, sipërfaqe e pasurisë 119.2 m/2, ref 010387, nr. dokumenti 10989, date 28.10.2008, me vlere te pasurise 11.997.480 Leke, ne emër te shtetasve [redacted] dhe [redacted]

Gjykata çmon se jemi në kushtet e parashikuara nga nenet 274 të K.Pr.Penale dhe kërkesa e prokurorit duhet pranuar.

I dyshuari [redacted] është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime në datën 28.7.2015 dhe ka deklaruar se ka njohje me [redacted] dhe [redacted], por nuk paraqet ndonjë njohje të posaçme që të justifikoj besimin e tyre për të ta lënë atë përfaqësues me të drejtë të shitjes së pronës së tyre dhe administrimit të tyre pa përfitim.

Është bërë këqyrja e vendit të ngjarjes datë 20.7.2015 dhe ka rezultuar se pasuritë objekt gjykimi administrohen nga i dyshuari [redacted], dhe ka firmosur në fund këqyrjen.

Shitja apo përdorimi i të drejtave reale mbi pasurine e paluajtshme objekt sekuestro mund të lehtësoj kryerjen e veprave të tjera penale, pasi shitja e këtyre pasurive i krijon atij të ardhura që mund të lehtësojnë kryerjen e krimit.

Dyshimi që këto pasuri janë vënë nga të ardhurat e veprimtarisë kriminale provohet me vendimin e denimit nga gjykatat angleze dhe mungesa e justifikimit nga i dyshuari se këto pasuri janë vënë në mënyrë të ligjshme. Gjykata mbështet analizen e provave të bërë nga prokurori pa u zgjatur për të bërë një interpretim të njëjtë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 378 e vijues të K.Pr.Penale,

VENDOSI


Pranimin e kërkesës sipas N.274 të K.Pr.Penal.

Vendosjen e sekuestros preventive, mbi pasurinë me Nr.2/980, vol.46, fq.98, zona kadastrale Nr.8511, me sipërfaqe truall 178 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 76 m² në emër të / , ndodhur në Rr "Aleksandër Goga" Durrës. Pasuria Nr.27/168 N D-N2, vol.55, fq.195, sipërfaqe 119.2 m², të ndodhur në Lagjen nr.13 Plazh Durrës, në emër të :

Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Durrës. Për personat e interesuar afati i ankimit i fillon nga momenti i marrjes dijeni.

U shpall në Durrës me 27/7/2015, ora.11.45

Sekretare
Edlira Mehmeti



GJYQATAR
Tritan HAMITAJ



VENDIMI MORI FORMË TË PRERË

Date 06/08/15

Kryesekretare
Marsida Shullani

